REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.236/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Hajriz Hoti kryesues, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit, Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK), dhe Lëvizja për bashkëveprim (LPB), me seli në Ferizaj, të paraqitur kundër Subjektit Politik, Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Ferizaj, për shkak të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë;30.01.2025, merr këtë,

## V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK), dhe Lëvizja për bashkëveprim(LPB), me seli në Komuna Ferizaj, Anr.236/2025 e datës;28.01.2025.

II. Subjektit Politik Partia, Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Komunën e Ferizaj, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 1.000,00 €uro (Njëmijë) €uro.

III. Detyrohet Subjektit Politik, Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Ferizaj, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

## A r s y e t i m

Me datë;28.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Koalicioni, Partia Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK), me të cilën pretendon se Besart Jashari , kandidat për subjektin politik Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), për zgjedhjet parlamentare 2025, njëherit personi në fjalë është zyrtar i lartë politik në PAI dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës. Po ashtu në vazhdim të ankesës theksohet se i lartpërmenduri është pjesë e organizatës Humanitare, RAHMETI" dhe gjatë fushatës elektorale, Besart Jashari bashkë me stafin e kësaj organizate humanitare bënë shpërndarjen e ndihmave tek familjet skamnore. Sipas pretendimeve në ankesë veprimet e tija janë si formë e korrupsionit, shantazhit, ndikimit të drejtpërdrejt tek votuesit dhe kjo përbën shkelje të kodit të mirësjelljes dhe ligjit për zgjedhjet e përgjithshme.

Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ka bashkangjitur fotografit e shpërndarjes së ndihmave nga kandidati i lartcekur, fotografi të stafit dhe video në teren të publikuar në linkun e të njëjtit kandidat në rrjetin social facebook.

Më datë 28.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 29.01.2025.

Në përgjigjen në ankesë nga Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), se Besart Jashari, është parë duke shpërndarë dru në kuadër të një akti korruptiv apo shantazhi theksojnë kjo akuzë është e pavërtetë. Më tutje në përgjigjen e tyre theksojnë se Besart Jashari është vullnetar dhe kontribues i rregullt i Shoqatës Humanitare Rahmeti që nga viti 2017, dhe ai ka qenë gjithmonë i pranishëm në shpërndarjen e ndihmave për familjet në nevojë, përfshirë drutë për ngrohje, pako ushqimore dhe ushqime për të varfërit. PAI në përgjigjen e tyre theksojnë se nga biseda me Besart Jasharin dhe përfaqësuesit e shoqatës Rahmeti, konfirmohet se shpërndarja e druve është bërë për familjet me jetimë, të moshuarit dhe persona me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë të drejtë vote apo nuk janë në gjendje të kryejnë detyrat e tyre bazë, e aq më pak të ndikohen në procesin zgjedhor. Më tutje theksojnë se Besart Jashari është kontabilist dhe zotëron një agjenci udhëtimesh në Ferizaj dhe ai ka vënë gjysmën e zyrës së tij në dispozicion të Shoqatës Humanitare Rahmeti për aktivitetet e saj, duke ofruar gjithashtu shërbime kontabiliteti pa pagesë për këtë organizatë dhe angazhimi i tij në këtë shoqatë është plotësisht vullnetar dhe pa asnjë përfitim financiar apo politik. Përgjigjes në ankesë ka bashkangjitur fotografitë e aktiviteteve humanitare të Besart Jasharit me Shoqatën Rahmeti.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës vëren se ankesa është e bazuar.

Paneli, pas shikimit të provave materiale, dhe videos së publikuar në faqen "Rahmeti" në Facebook, ku vërehet se kandidati për deputet nga subjekti politik, Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), Besart Jashari, i cili në bashkëpunim me organizatën, "Rahmeti" gjatë fushatës zgjedhore ka shpërndarë ndihma me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve, sepse shpërndarja e ndihmave gjatë fushatës zgjedhore është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1.6, e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *"premtimi i ndonjë shpërblimi financiar me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve"*

Pretendimi në përgjigje në ankesë i subjektit politik, Partia Ashkalinjve për Integrim (PAI), se kandidati i tyre, Besart Jashari ka bërë shpërndarje të ndihmave tek qytetarët për përfitim të votuesve janë të pavërteta, sepse i njëjti është vullnetar dhe kontribues i rregullt i Shoqatës Humanitare, Rahmeti që nga viti 2017, ky pretendim është i pa bazuar për Panelin, pasi kandidati për deputet shihet duke shpërndarë ndihma gjatë fushatës zgjedhore.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e parashtruar e konsideron të bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera të përgjigjes në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika l.6, nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr.236/2025, datë;30.01.2025

Kryesues i Panelit

Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.